



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË ZBATUARA

Tetovë, 24. 04. 2023

**Fakulteti i Shkencave të Zbatuara- Факултет за применети науки- Faculty of Applied
Sciences**

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i procesit të vetevaulimit.....	3
2. Përshkrimi i Fakultetit.....	4
2.1. Historiku	4
2.2. Misioni	6
2.3. Strategjia e zhvillimit	6
3. Struktura organizative e Fakultetiti	8
3.1. Organogrami	8
3.2. Programet studimore	8
4. Veprimtaria mësimore.....	10
5. Struktura e kuadrit mësimor - shkencor	12
6. Struktura e studentëve	18
6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike	18
6.2. Struktura e studentëve në studimet e magjistraturës	22
6.3. Struktura e studentëve në doktoraturë.....	23
7. Realizimi i orës mësimore në programet studimore të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara	24
8. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte	27
9. Hapësirat dhe resurset materiale	34
10. SWOT Analiza.....	37
11. Konkludimi	39

1. Qëllimi i procesit të vetevaluimit

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të bëhet evaluimi i procesit mësimor në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara në vitet akademike 2019/2020; 2020/2021 dhe 2021/2022. Evaluimi i brendshëm është një detyrim dhe obligim që rrjedh nga rregullativat ligjore, siç janë Ligji për arsimin e lartë dhe Statuti i UT-së. Qëllimi i vetevaluimit ishte që të shohim se si ka rrjedhur dhe si është zhvilluar procesi mësimor në këto vite akademike dhe në përgjithësi si është zhvilluar FSHZ-ja. Përfundimet të cilat do të dalin nga ky raport i evaluimit do të shërbejnë si bazë për zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të kualitetit të procesit mësimor-shkencor. Evaluimi është realizuar nga Komisioni i brendshëm për vetevaluim i caktuar nga Këshilli mësimor i FSHZ-së në mbledhjen e mbajtur me 16.11.2020 dhe Vendimi për formimin e anëtarëve të Komisionit me Nr. 17-774/6, Datë; 11.12. 2020, Tetovë.

Në procesin e evaluimit u përfshinë këta komponentë:

- Vlerësimi i programeve studimore, ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore,
- Struktura e kuadrit mësimor,
- Struktura e studentëve deridiplomike dhe master,
- Mënyra e realizimit të procesit mësimor,
- Struktura e kuadrit udhëheqës, administrativ dhe teknik,
- Anketimi i studentëve,
- Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte,
- Hapësirat dhe mjetet për realizimin e procesit mësimor.

Gjatë realizimit të procesit të evaluimit për përgatitje të këtij raporti, përveç anëtarëve të këtij komisioni janë shfrytëzuar edhe profesorë, studentë si dhe administrata, për marrjen dhe shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme.

2. Përshkrimi i Fakultetit

2.1. Historiku

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara funksionon në kuadër të Universitetit të Tetovës. Me aprovimin e Ligjit për themelimin të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në vitin 2004, në kuadër të Universitetit Shtetëror të Tetovës, me mësim në gjuhën shqipe u formuan pesë fakultete, mes të cilëve edhe Qendra për Studime Politeknike me dy programe studimore:

1. Ndërtimtari

2. Bioteknologji - me studime trevjeçare, apo gjashtë semestra.

Në vitin 2008, aprovohet ligji i ri për Universitetin Shtetëror të Tetovës, me të cilin u ndryshua dhe u plotësua ligji i vitit 2004. Me këto ndryshime, Qendra për Studime Politeknike transformohet në fakultete të veçanta: ***Fakulteti i Shkencave të Zbatuara*** dhe ***Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore***, në kuadër të Universiteti Shtetëror të Tetovës. Në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, përveç programit studimor të Ndërtimtarisë i cili është transferuar nga QSP, u hapën edhe tre programe të reja studimore, si: Arkitektura, Mekatronika dhe Inxhinieria Ekonomike. Dy programet studimore, Mekatronikë, e cila funksiononte në kuadër të FSHMN-së dhe Inxhinieri Ekonomike e cila funksiononte në kuadër të Fakultetit Ekonomik, kishin filluar vitin e parë akademik në vitin 2006/07.

Në programet e reja studimore të akredituara në vitin 2007 studimet akademike zgjasnin 7 semestra dhe kishin 210 kredi. Në tri programe studimore, Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Inxhinieri Ekonomike, një semestër i tërë që përfshinte 30 ECTS realizohej në praktikë, kurse në programin studimor të Arkitekturës realizohej praktikë 8-javore. Këto studime sipas akreditimit të parë zgjatën deri në vitin 2012/2013. Në vitin 2013 për nevoja të realizimit të praktikës së studentëve të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, u themelua edhe Laboratori për testimin dhe kontrollimin e materialeve ndërtimore.

Nga viti 2013/2014 studimet në programet studimore fillojnë sipas akreditimit të ri dhe sipas procesit të Bolonjës. Sipas këtij akreditimi/riakreditimi, studimet në programin studimor të Arkitekturës zgjasin katër vjet, tetë semestra me 240 ECTS, kurse në programet studimore Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Inxhinieri Ekonomike zgjasin tre vjet ose gjashtë semestra me 180 ECTS.

1. *Arkitekturë, me 240 ECTS kredi*
2. *Ndërtimtari, me 180 ECTS kredi*
3. *Mekatronikë, me 180 ECTS kredi*
4. *Inxhinieri Ekonomike, me 180 ECTS kredi*

Nga viti 2015/16 në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara fillojnë me punë edhe dy programe studimore të reja të akredituara dhe atë: ***programi studimor Inxhinieria e Komunikacionit – Transportit*** me katër vjet, tetë semestra dhe 240 ECTS dhe programi studimor ***Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë*** me tre vjet, gjashtë semestra dhe 180 ECTS.

5. ***Inxhinieri e Komunikacionit – Transportit, me 240 ECTS kredi***
6. ***Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë, me 180 ECTS kredi***

Në programin studimor Inxhinieri Ekonomike nga viti 2013/2014 me akreditim të ri e deri në vitin akademik 2020/2021, nuk ka pasur të regjistruar studentë në asnjë vit edhe pse konkursi gjithmonë, në çdo vit ka qenë i hapur. Edhe në programin studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë nga viti shkollor 2019/2020 e deri në vitin shkollor 2020/2021 deri sa ishte programi i akredituar në fuqi, nuk ka pasur studentë të rinj të regjistruar në vitin e parë. Prandaj, për këto dy programe studimore nuk është përgatitur elaborat i ri për akreditim/riakreditim. Regjistrimi i fundit i studentëve në vitin e parë me këtë program studimor të akredituar ka qenë viti shkollor 2020/2021. Prandaj, për këta studentë ky program studimor do të jetë aktiv sa dyfishi i kohëzgjatjes së studimeve të rregullta.

Nga viti shkollor 2021/2022 në vitin e parë ligjëratat fillojmë sipas akreditimit/riakreditimit të ri e që është i treti me radhë në programet studimore siç janë:

1. *Arkitekturë, me 300 ECTS kredi*
2. *Ndërtimtari, me 240 ECTS kredi*
3. *Mekatronikë, me 240 ECTS kredi*
4. ***Inxhinieri Komunikacioni – Transport, me 240 ECTS kredi***

Po ashtu kemi edhe akreditim/riakreditim edhe të programeve studimore në master:

1. *Ndërtimtari, me 120 ECTS kredi*
2. *Ndërtimtari, me 60 ECTS kredi*
3. *Mekatronikë, me 120 ECTS kredi*
4. *Mekatronikë, me 60 ECTS*
5. ***Inxhinieri Komunikacioni – Transport, me 60 ECTS kredi***

Studimet në programet studimore: Arkitekturë, Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Inxhinieri e Komunikacionit - Transportit fillojnë sipas akreditimit të ri. Meqë disa vite më parë në programin studimor të Gjeodezisë dhe Gjeoinformatikës nuk ka pasur studentë të rinj të regjistruar por nuk ka pasur as staf të rregullt, nuk është bërë akreditim i ri për këtë program studimor.

Sipas akreditimit të ri, në Arkitekturë, duke qenë program studimor i integruar sipas Ligjit për arsimin e lartë studimet zgjasin 5 vjet, dhjetë semestra. Ndërsa, në drejtimet tjera Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Inxhinieri e Komunikacionit - Transportit zgjasin 4 vjet, tetë semestra. Po ashtu, në programet studimore; Ndërtimtari, Mekatronikë janë akredituar edhe programet master me 60 ECTS dhe 120 ECTS, kurse në programin studimor Inxhinieri e Komunikacionit - Transportit studimet Master me 120 ECTS. Në programin e Arkitekturës në këtë periudhë kohore nuk është kërkuar akreditim për Master.

2.2. Misioni

Misionit i Fakulteti i Shkencave të Zbatuara është nxjerrja e kuadrove profesionale dhe kualitative në drejtimet inxhinierike për plotësimin e nevojave shoqërore. Po ashtu, krijimin e kuadrit profesional akademik shkencor për nevojat e fakultetit të cilët do të jenë në gjendje ta zhvillojnë procesin mësimor dhe t'u përgjigjen sfidave të kohës.

2.3. Strategjia e zhvillimit

Duke u bazuar në misionin e fakultetit, kryesisht nevojave të tij dhe të shoqërisë në vendin tonë, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara në strategjinë e vet zhvillimore, ka vendosur qëllimet dhe objektivat e veta. Në këtë drejtim, është duke punuar vazhdimisht në funksionimin dhe realizimin e procesit mësimor në drejtimet ekzistuese duke plotësuar kushtet e nevojshme për realizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor sipas procesit të Bolonjës duke ofruar sistemin e transferit të kredive dhe në këtë mënyrë duke bashkëpunuar dhe mundësuar studentëve bartjen e kredive të tyre në universitete tjera dhe nga universitetet tjera. Në kuadër të programit Erasmus plus, nga Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, programet e ndryshme studimore kemi pasur një numër të studentëve të cilët përmes këtij programi bashkëpunimi dhe transferi të kredive kanë dëgjuar semestrin mësimor në universitete të ndryshme.

Për realizimin me sukses të procesit mësimor në vazhdimësi tentohet të sigurohet kadri profesional adekuat, fillimisht profesorë në lëmenj të ndryshëm për mbulimin e të gjitha lëndëve por edhe duke përzgjedhur asistentët më të mirë nga radhët e studentëve të vet dhe më gjerë. Duke inkuadruar ato, fillimisht në procesin mësimor si praktikantë, demonstratorë dhe më tej në asistentë. Fakulteti, është në bashkëpunim me shumë fakultete tjera në vendit dhe vendeve fqinjë me ç'rast për nevoja të ndryshme ekziston bashkëpunim i kuadrit mësimor.

Përveç Laboratorit për kontrollin dhe testimin e materialeve i cili është një ndër laboratorët me pajisje më të mira në vend, në vazhdimësi përmirësohen edhe kabinetet për zhvillimin e ligjëratave dhe ushtrimeve të ndryshme me programe softuerike që zhvillohen në drejtime të ndryshme.

Objektivat dhe qëllimet afatgjata të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara janë përcjellja e zhvillimeve shoqërore industriale duke krijuar kuadro profesionale për nevojat e industrisë dhe shoqërisë. Kjo do të thotë që sipas nevojës së industrisë dhe shoqërisë të mund të hapen edhe drejtime të reja. Prandaj, për realizimin dhe arritjen e këtyre objektivave fakulteti përveç procesit mësimor në ciklin e parë, organizon edhe procesin e studimeve akademike në ciklin e dytë. Në të ardhmen si objektiv mbetet organizimi i ciklit të tretë të studimeve të doktoraturës.

Që t'i bëjë ballë zhvillimit teknik-industrial si dhe nevojave të shoqërisë Fakulteti në bashkëpunim me organet më të larta të Universitetit është duke e ndjekur trendin e zhvillimit industrial si dhe nevojat dhe kërkesat e kompanive dhe kapaciteteve industriale në vend. Për këtë arsye ka një bashkëpunim me këto kapacitete prodhuese industriale me qëllim edhe të marrjes së informatave për nevojat dhe kërkesat e tyre, në mënyrë që në programet e veta studimore përmes lëndëve të ndryshme studimore të mundësojë përgatitjen dhe aftësimin e studentëve të cilët do të mund të jenë të aftë të inkuadrohen në këto kompani apo organe të ndryshme shtetërore.

Për realizimin e këtyre synimeve në të ardhmen sigurisht që kërkohet një përkrahje edhe më e madhe si nga aspekti material ashtu edhe nga ai kadrovik.

3. Struktura organizative e Fakultetit

3.1. Organogrami

Në Organogramin më poshtë është treguar mënyra e organizimit dhe funksionimit të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara bazuar në Ligjin për arsim të lartë të RMV-së.




Figura 1. Organogrami i Fakultetit

3.2. Programet studimore

Programet studimore në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara janë studime akademike. Studimet në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara janë të rregullta. Fakulteti i Shkencave të Zbatuara ofron programe studimore nga lëmi i shkencave teknike në përputhje me nevojat e tregut dhe të shoqërisë. Programet studimore të cilat realizohen në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara janë:

- Programi studimor: Arkitekturë

- Programi studimor: Ndërtimtari
- Programi studimor: Mekatronikë
- Programi studimor: Inxhinieri e Komunikacionit – Transportit

Duke ndjekur trendin e zhvillimit shoqëror, nevojat dhe kërkesat e tregut si dhe zhvillimet dhe të arriturat e reja shkencore në botë, kërkesat dhe risitë i implementojmë në programet e reja gjatë akreditimit/riakreditimit të tyre. Në këtë drejtim duke u bazuar në vlerësimet të cilat janë dhënë në raportin paraprak të evaluimit nga **Komisioni për evaluim të brendshëm** dhe kishin të bënin me vlerësimin e programeve studimore paraprake për indikatorë të ndryshëm të lëndëve, siç janë: *përputhshmëria e lëndës me fushën e studimit, kompetencat, vendosja e lëndëve nëpër semestrat e duhur, ngarkesa e studentëve, azhurnimi i lëndës sipas zhvillimeve të reja shkencore, si dhe statusi i saj në njërin anë dhe në anën tjetër* Universiteti, paraprakisht ishte ngritur një grup punues ku për çdo fakultet a program studimor është hulumtuar tregu, nevojat e tregut dhe kërkesat e tyre. Pikërisht këto dy elemente si dhe Ligji për arsimin të lartë të RMV-së dhe Klasifikimi Ndërkombëtar i Fraskatit kanë qenë baza kryesore gjatë përgatitjes së elaborateve për akreditimin e programeve të reja studimore.

Prandaj, duke u bazuar në këto elemente të lartpërmendura si dhe në parapërgatitjen dhe përvojën e stafit akademik, konkretisht komisioneve për përgatitjen e elaborateve për akreditim/riakreditim, programet tona të lartpërmendura u akredituan dhe i kanë marrë lejet për funksionim. Kjo është edhe një dëshmi e qartë dhe vlerësim për përmbajtjen profesionale të këtyre programeve studimore.

Në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara gjatë periudhës trevjeçare në vitet shkollore 2019/2020; 2020/2021 dhe 2021/2022, kur është kryer procesi i evaluimit kanë funksionuar këto programe studimore;

1. Programi studimor Arkitekturë,
2. Programi studimor Ndërtimtari,
3. Programi studimor Mekatronikë,
4. Programi studimor Inxhinieri Komunikacioni-Transporti,
5. Programi studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë, ka qenë aktivë vetëm për studentët e viteve paraprake dhe nuk ka pasur studentë të rinj të regjistruar në vitin shkollor akademik 2019/2020, 2020/2021 sipas akreditimit që ishte në fuqi (akreditimi i vjetër i vitit 2015).

Këto programe studimore do vazhdojnë të jenë aktive sa dyfishi i kohëzgjatjes studimore të tyre.

4. Veprimtaria mësimore

Në programet studimore të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara për periudhën e evaluimit 2019/2020; 2020/2021, procesi mësimor është zhvilluar sipas planprogrameve të vjetra kurse nga viti shkollor 2021/2022 procesi mësimor nga viti i parë fillon sipas akreditimit të ri. Në vitin shkollor 2019/2020 dhe në vitin shkollor 2020/2021, konkurset për pranim të studentëve në vitin e parë kanë qenë sipas akreditimeve të vjetra (të vitit 2014 dhe 2015), kurse nga viti shkollor 2021/2022 konkurset për pranim të studentëve në programet studimore ishin sipas akreditimeve të reja. Studimet dhe procesi mësimor sipas akreditimit të vjetër do të zgjasin sipas ligjit sa dyfishi i kohëzgjatjes së studimeve në programet studimore përkatëse. Studentët të cilët për arsye të ndryshme nuk do kenë mundësi që t'i përfundojnë studimet gjatë kësaj periudhe kohore, kanë mundësi të bëjnë transfer në ndonjë nga programet ekzistuese aktuale.

Në programet studimore sipas akreditimeve të vjetra (2014, 2015) numri i kredive të lëndëve në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara shtrihet minimum prej 2 kredive në lëndët opsionale, nga 3 në lëndët zgjedhore, deri në 7 kredi në lëndët obligative. Tema e diplomës në programet studimore, Ndërtimtari ka 9 kredi. Në programin studimor Mekatronikë dhe Inxhinieri Komunikacioni - Transporti janë me 10 kredi, në programin studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë tema e diplomës ka 5 kredi dhe në programin studimor Arkitekturë tema e diplomës ka 15 kredi. Programet studimore përbëhen nga lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale.

Në vitin shkollor akademik 2021/2022 procesi mësimor nga viti i parë fillon me akreditimin e ri. Sipas akreditimit të ri studimet në programet studimore Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Inxhinieri Komunikacioni - Transporti zgjasin katër vjet, tetë semestra dhe studentët akumulojnë 240 ECTS kredi. Në programin studimor Arkitekturë studimet zgjasin pesë vjet ose 10 semestra dhe studentët akumulojnë 300 ECTS.

Numri i kredive të lëndëve në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara shtrihet minimum prej 3 kredive në lëndët zgjedhore e deri në 7 kredi në lëndët obligative. Tema e diplomës në programet studimore, Ndërtimtari është një semestër dhe përbëhet prej dy pjesëve, pjesës

teorike e cika ka 5 kredi dhe pjesës së dytë, projektit i cili ka 25 kredi. Në programin studimor Mekatronikë tema e diplomës ka 15 kredi, në programin studimor Inxhinieri Komunikacioni - Transporti tema ka 8 kredi, në programin studimor Arkitekturë tema e diplomës ka 30 kredi. Programet studimore përbëhen nga lëndët obligative dhe zgjedhore.

Në të gjitha programet studimore të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara realizohet mësimi teorik por edhe ai praktik. Studentët realizojnë praktikën në institucione me të cilat është lidhur marrëveshje bashkëpunimi nga Universiteti, konkretisht në komuna, kompani vendore, firma të licensuara private ndërtimore, Laboratorin e ndërtimtarisë që është në kuadër të FSHZ-së. Gjatë realizimit të praktikës, studentët evidentojnë dhe përshkruajnë punën e tyre në ditarët praktikë. Këto punime më tej studentët i prezantojnë, i mbrojnë përpara profesorit të lëndës ose i dorëzojnë në formë të elaborateve apo punimeve.

Procesi i mësimdhënies realizohet përmes procesit të ligjëratave dhe ushtrimeve të cilat janë obligative si dhe përmes aktiviteteve tjera, siç janë: punime individuale, seminare, projekte dhe elaborate. Gjatë një semestri realizohen në kuadër të çdo lënde nga dy kolokuiume. Provimi në fund të semestrit mund të kryhet përmes pikëve të grumbulluara në aktivitetet e cekura më lart, ose nëse studenti nuk mund t'i grumbullojë pikët e caktuara për notë pozitive, ai i nënshtrohet provimit përfundimtar i cili përmban përqindjet e dy kolokuiumeve. Këto forma caktohen sipas sylabusit për çdo lëndë sipas karakteristikave të lëndës. Në fund të mbarimit të lëndës me sukses studenti përfiton njohuri të mjaftueshme nga secila lëndë, ndërsa këto njohuri jo vetëm që do t'i zotërojë por edhe do të jetë në gjendje t'i përdorë dhe t'i zbatojë në praktikë në lëmin e caktuar. Në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara specifike janë lëndët projektuese. Ekuivalencë e kolokuiumeve në lëndët projektuese është realizimi i projekteve i cili shkon në dy faza paraprake, respektivisht para dorëzimit final të projektit. Në kuadër të FSHZ-së është Laboratori i cili posedon pajisje për testimin dhe kontrollimin e agregatit, zhavorrit, betonit të freskët, çimentos dhe llaçit. Gjithashtu, pajisjet e Laboratorit mundësojnë testim të konstruksioneve të betonit me metoda joerozive si dhe përcaktimin dhe matjen e thellësisë së armaturës.

Procesi i transferit të kredive u mundëson studentëve që në çdo semestër varësisht nga parakushtet për dëgjim dhe provim të regjistrojnë nga 35 kredi, kurse për studentët e viteve të fundit deri në 40 kredi. Paraqitja e lëndëve për regjistrim të semestrit, si dhe paraqitja e provimeve bëhen përmes sistemit online ose me prezencë fizike.

Duhet të theksojmë se procesi mësimor në vitin shkollor akademik 2019/2020 në semestrin dimëror është mbajtur me prezencë fizike. Kurse semestri veror 2019/2020 filloi me prezencë fizike deri me 10.03.2019 por për shkak të paraqitjes së pandemisë Kovid 19, për shkak të masave izoluese nga 11.03.2020 pas një jave pushim, procesi mësimor filloi të mbahej online përmes *google meet* deri në fund. Edhe kolokuiumet dhe provimet në afatin e qershorit, korrikut dhe shtatorit janë mbajtur online. E gjithë administrata, duke përfshirë këtu edhe procesin e regjistrimit të studentëve të rinj në vitin shkollor akademik 2020/2021 ka funksionuar me sistemin online. Procesin mësimor, kolokuiumet dhe provimet në këtë vit akademik filluan dhe mbaruan me sistemin e kombinuar, online dhe me prezencë fizike. Në vitin shkollor akademik 2021/2022 procesi mësimor, kolokuiumet dhe provimet filluan vetëm me prezencë fizike.

5. Struktura e kuadrit mësimor - shkencor

Në programet studimore të FSHZ-së, respektivisht, Arkitekturë, Ndërtimtari, Mekatronikë, Inxhinieri Komunikacioni - Transporti dhe Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë, struktura e mësimdhënësve të rregullt është e përbërë prej 12 profesorëve dhe si drejtime specifike me lëndë të ndryshme në mësimdhënie të inkuadruar janë edhe 13 profesorë me kontratë. Me këtë strukturë këto programe edhe më tej vazhdojnë të perceptohen se janë profesione të gjinisë mashkullore. Më tej, nëse shohim proporcionin e mësimdhënësve me studentët, vërejmë se një profesori si dhe një bashkëpunëtor apo asistenti, i takon të punojë me 40 studentë në pjesën e ligjëratave kurse në pjesën e ushtrimeve ose ushtrimeve hulumtuese laboratorike me nga 10 studentë. Pasi që vetë natyra e studimeve në programet studimore të FSHZ-së, respektivisht aktiviteti i studentëve dhe detyrat e projektet që priten të realizojnë e që njëkohësisht orientohen drejt profesionalizimit të mirëfilltë, kërkojnë që mësimdhënia të realizohet thuajse në mënyrë individuale duke ndjekur punën dhe detyrat e çdo studenti, numri i vogël i stafit, e ngarkon punën e mësimdhënësve të rregullt. Prej këtu del edhe nevoja që të angazhohen me kontratë (13) profesorë dhe bashkëpunëtorë asistentë ku numri i përgjithshëm i asistentëve të rregullt është (6) kurse bashkëpunëtorë asistentë me kontratë (33). Tashmë ky numër i stafit në FSHZ kontribuon që të realizohet në mënyrë të mirëfilltë procesi i mësimdhënies edhe atë, për profesorët si dhe për bashkëpunëtorët apo asistentët me nga rreth 10 studentë të cilët në drejtime si programi i Arkitekturës janë të ndarë

në grupe. Mësimdhënësit e angazhuar me kontratë në vepër janë të përzgjedhur nga universitetet e tjera siç është Universiteti i Prishtinës dhe nga universitetet e Tiranës dhe që janë profesorët më eminentë në fushat përkatëse të cilat i ligjërojnë në FSHZ. Tabelat më poshtë japin një pasqyrë më të detajuar rreth titujve akademikë dhe moshës mesatare, gjinisë së të gjithë të angazhuarve në këtë fakultet, ku janë të ndarë edhe sipas programeve studimore të cilat funksionojnë në suaza të FSHZ-së.

Kuadri mësimor - shkencor i FSHZ-së

Tabela 1. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Mësimdhënëës									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Ordinar	3	/	60	3	Ordinar	1	1	60	2
Inordinar	7	/	50	7	Inordinar	5	1	57	6
Docent	1	1	43	2	Docent	4	1	48	5
Gjithsej	11	1	51	12	Gjithsej	10	3	55	13

Tabela 2. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Asistent	2	4	30	6	Asistent	14	16	45	27
Asistent doktorant	/	/	/	/	Asistent i ri	2	1	30	3
Gjithsej	2	4	30	6	Gjithsej	16	17	35	33

Programi studimor Arkitekturë

Në programin studimor Arkitekturë procesin mësimor gjithsej e realizojnë 25 mësimdhënëës. Prej tyre, 10 të rregullt, më konkretisht 2 profesorë ordinarë, 1 profesor inordinar, 2 docentë, dhe 5 bashkëpunëtorë asistentë. Në programin studimor të Arkitekturës numri i studentëve në 4 gjenerata është mbi 140. Mësimdhënësit por edhe bashkëpunëtorët janë në përcjelljen e punës së një numri të madh të studentëve. Në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22, në programin studimor Arkitekturë janë angazhuar 15 mësimdhënëës me kontratë, ose konkretisht 3 profesorë dhe 12 bashkëpunëtorë. Kjo kontribuon që mësimdhënësit respektivisht profesorët dhe bashkëpunëtorët të përcjellin numrin e 25

studentëve gjë që kontribuon në mbarëvajtjen dhe ndjekjen e projekteve individuale të studentëve ashtu siç e kërkon edhe natyra e programit studimor të Arkitekturës.

Tabela 3. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Arkitekturë)

Profesorë									
Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Ordinar	2	/	47	2	Ordinar	/	1	55	1
Inordinar	1	/	42	1	Inordinar	/	1	60	1
Docent	1	1	44	2	Docent	/	1	42	1
Asistent doktorant	/	/	/	/	Ligjërues (Dr.sc)	/	/	/	/
Gjithsej	4	1	/	5	Gjithsej	/	3	/	3

Tabela 4. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Arkitekturë)

Bashkëpunëtorë									
Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Asistent	1	4	32	5	Asistent	1	8	38	9
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	2	1	30	3
	/	/	/	/		/	/	/	/
Gjithsej	1	4	/	5	Gjithsej	3	9	/	12

Programi studimor Ndërtimtari

Në programin studimor Ndërtimtari, në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 procesin mësimor e kanë realizuar gjithsej 11 mësimdhënës. Më konkretisht prej tyre (4) janë mësimdhënës të rregullt, 3 profesorë inordinarë dhe një (1) asistent. Nga numri i përgjithshëm i studentëve dhe i gjithë stafit të angazhuar, në programin studimor Ndërtimtari, arrihet që të përcillet puna e 12 gjegjësisht rreth 14 studentëve nga një profesor dhe nga një bashkëpunëtor.

Tabela 5. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Ndërtimtari)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Ordinar	/	/	/	/	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	3	/	60	3	Inordinar	1	/	62	1
Docent	/	/	/	/	Docent	1	/	60	1

Asistent doktorant	/	/	/	/	Ligjërues (Dr.sc)	/	2	47	2
Gjithsej	3	/	/	3	Gjithsej	1	2	/	4

Tabela 6. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Ndërtimtari)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Asistent	1	/	30	1	Asistent	/	/	/	/
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	3	/	30	3
Gjithsej	1	/	/	1	Gjithsej	3	/	/	3

Programi studimor Mekatronikë

Në programin studimor Mekatronikë procesi mësimor realizohet nga 14 mësimdhënës prej të cilëve 2 profesorë në marrëdhënie të rregullt pune, që kontribuojnë më shumë në ecurinë e studentëve rreth punës praktike, temave të diplomës, punëve laboratorike si drejtim specifik kurse 5 profesorë dhe 6 asistentë me kontratë në vepër. Angazhimi i stafit të jashtëm në programin studimor të Mekatronikës kontribuon që të reduktohet numri i ndjekjes së studentëve në mësimdhënie dhe në pjesën praktike, punëve eksperimentale laboratorike etj., pasi që si drejtim specifik ndonjëherë edhe kërkon demonstrime individuale për studentë.

Tabela 7. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Mekatronikë)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Ordinar	1	/	55	1	Ordinar	1	/	62	1
Inordinar	1	/	55	1	Inordinar	1	/	55	1
Docent	/	/	/		Docent	2	/	55	2
		/			Ligjërues (Dr.sc)	1	/	50	1
Gjithsej	2	/	55	2	Gjithsej	5	/	55.5	5

Tabela 8. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Mekatronikë)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Asistent	/	/	/	/	Asistent	3	/	45	3
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	2	1	26	3
	/	/	/	/		/	/		

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara- Факултет за применети науки- Faculty of Applied Sciences

Str. Ilinden mn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk

Gjithsej	/	/	/	/	Gjithsej	5	1	/	6
----------	---	---	---	---	----------	---	---	---	---

Programi studimor Inxhinieri Komunikacioni - Transporti

Në programin studimor Inxhinieri Komunikacioni - Transporti në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22, procesin mësimor e kanë realizuar gjithsej 13 mësimdhënës. Më konkretisht 2 profesorë të rregullt, 4 profesorë me kontratë në vepër dhe 7 bashkëpunëtorë (asistentë) janë me kontratë në vepër.

Tabela 9. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Inxhinieri Komunikacioni – Transporti)

Profesorë									
Te Tabela 10. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitin akademik; 2019/20, 2020/21,2021/22 (Inxhinieri Komunikacioni – Transporti) Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Ordinar	/	/	/	/	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	2	/	55	2	Inordinar	3	/	55	3
Docent	/	/	/	/	Docent	1	/	55	1
	/	/	/	/	Ligjërues (Dr.sc)	/	/	/	/
Gjithsej	/	/	55	2	Gjithsej	4	/	55	4

Tabela 10. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Inxhinieri Komunikacioni – Transporti)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Asistent	/	/	/	/	Asistent	5	2	47	7
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	/	/	/	/
	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	/	/	/	/	Gjithsej	7	2	47	7

Programi studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë

Programi studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë, ka qenë aktiv vetëm për studentët e viteve paraprake dhe nuk ka pasur studentë të rinj të regjistruar në vitin shkollor akademik 2019/2020, 2020/2021 sipas akreditimit që ishte në fuqi (akreditimi i vjetër i vitit 2015). Këto programe studimore do vazhdojnë të jenë aktive sa dyfishi i kohëzgjatjes studimore të tyre.

Në programin studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë në vitin akademik 2019/2020, 2020/2021, procesin mësimor e kanë realizuar gjithsej 10 mësimdhënës. Më konkretisht 1 asistent doktorant kuadër i rregullt dhe 4 profesorë me kontratë dhe 5 bashkëpunëtorë (asistentë) me kontratë.

Tabela 11. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor në vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë)

Profesorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	/	/	/	/	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	/	/	/	/	Inordinar	/	/	/	/
Docent	/	/	/	/	Docent	/	/	/	/
Asistent doktorant	1	/	33	1	Ligjërues (Dr.sc)	/	/	/	/
Gjithsej	1	/	33	1	Gjithsej	/	/	/	/

Tabela 12. Struktura e bashkëpunëtorëve për vitin akademik 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22 (Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë)

Bashkëpunëtorë									
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali	Kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Totali
Asistent	/	/	/	/	Asistent	/	/	/	/
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	/	/	/	/
	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	/	/	/	/	Gjithsej	/	/	/	/

6. Struktura e studentëve

6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Në vazhdim në mënyrë tabelare dhe me diagrame kemi paraqitur numrin e përgjithshëm të studentëve në kuadër të FSHZ-së, si dhe numrin e studentëve në çdo program studimor për vitet 2019/20; 2020/21 dhe vitin 2021/22.

Tabela 13. Struktura e studentëve në FSHZ në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

FSHZ	2019/2020			2020/2021			2021/2022		
	S	M	F	S	M	F	S	M	F
ARKITEKTURË	245	133	112	234	119	116	216	74	98
NDËRTIMTARI	61	51	10	83	70	13	72	55	17
MEKATRONIKË	49	48	1	71	69	2	61	58	3
GJEODEZI DHE GJEONFORMATIKË	54	45	9	39	32	7	38	33	5
INXHINIERI KOMUNIKACIONI -TRANSPORTI	29	25	4	38	32	6	32	27	5
Gjithsej	438	302	136	465	322	144	419	247	128
Të çregjistruar	5	5	0	7	4	3	10	8	3





Figura 1. Numri i përgjithshëm i studentëve në FSHZ

Figura 2. Numri i studentëve sipas gjinisë në FSHZ

Programi studimor Arkitekturë

Tabela 14. Struktura e studentëve në Arkitekturë në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Arkitekturë	2019-2020			2020-2021			2021-2022		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	40	18	22	35	19	17	25	16	9
II	39	21	18	27	8	19	22	10	12
III	38	18	20	38	20	18	26	9	17
IV	128	76	52	134	72	62	143	74	69
V									
Total	245	133	112	234	119	116	216	74	98
Te çregjistruar	3	3		6	3	3	7	5	2




Figura 3. Numri i studentëve në programin studimor Arkitekturë




Figura 4. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor Arkitekturë

Programi studimor Ndërtimtari

Tabela 15. Struktura e studentëve në Ndërtimtari në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Ndërtimtari	2019-2020			2020-2021			2021-2022		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	7	5	2	9	5	4	8	6	2
II	16	12	4	4	3	1	6	3	3
III	38	34	4	70	62	8	58	46	12
Total	61	51	10	83	70	13	72	55	17
Te çregjistruar				1	1		1	1	




Figura 5. Numri i studentëve në programin studimor **Ndërtimtari**




Figura 6. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Ndërtimtari**

Programi studimor Mekatronikë

Tabela 16. Struktura e studentëve në Mekatronikë në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Mekatronikë	2019-2020			2020-2021			2021-2022		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	11	11		16	16		22	20	2
II	14	13	1	14	13	1	6	6	
III	14	14		41	40	1	33	32	1
Total	49	48	1	71	69	2	61	58	3
Te çregjistruar							1	1	




Figura 7. Numri i studentëve në programin studimor **Mekatronikë**




Figura 8. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Mekatronikë**

Programi studimor Inxhinieri Komunikacioni – Transporti

Tabela 17. Struktura e studentëve në Inxhinieri Komunikacioni – Transporti në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Inxhinieri Komunikacioni dhe Transporti	2019-2020			2020-2021			2021-2022		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	7	5	2	7	6	1	7	7	
II	8	7	1	7	5	2	4	3	1
III	9	9		9	8	1	7	5	2
IV	5	4	1	15	13	2	14	12	2
Total	29	25	4	38	32	6	32	27	5
Te çregjistruar	2	2					1	1	1




Figura 10. Numri i studentëve në programin studimor Inxhinieri Komunikacion – Transporti




Figura 11. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor Inxhinieri Komunikacion – Transporti

Programi studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë

Tabela 18. Struktura e studentëve në Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Gjeodezi dhe gjeoinformatikë	2019-2020			2020-2021			2021-2022		
	Studentë	M	F	Studentë	M	F	Studentë	M	F
I	14	12	2	1	1		2	2	
II				12	10	2			
III	40	33	7	26	21	5	36	31	5
Total	54	45	9	39	32	7	38	33	5
Te çregjistruar									




Figura 12. Numri i studentëve në programin studimor **Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë**




Figura 13. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë**

6.2. Struktura e studentëve në studimet e magjistraturës

Në studimet e nivelit master gjatë këtyre viteve të evaluimit procesi mësimor është zhvilluar në programet studimore: *Arkitekturë, Mekatronikë dhe Ndërtimtari*.

Në vazhdim në mënyrë tabelare kemi paraqitur numrin e studentëve ndër vite:

Tabela 19. Struktura e studentëve në FSHZ në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

FSHZ	2019-2020			2020-2021			2021-2022		
	S	M	F	S	M	F	S	M	F
ARKITEKTURË	10	5	5	4	4	0	3	3	0
MEKATRONIKË	4	4	0	3	2	1	4	3	1
NDËRTIMTARI	/	/	/	17	15	2	22	17	5
Gjithsej	14	9	5	24	21	3	29	23	6




Figura 14. Numri i studentëve në programin studimor **Arkitekturë**




Figura 15. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Arkitekturë**




Figura 16. Numri i studentëve në programin studimor **Mekatronikë**




Figura 17. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Mekatronikë**




Figura 18. Numri i studentëve në programin studimor **Ndërtimtari**




Figura 19. Numri i studentëve sipas gjinisë në programin studimor **Ndërtimtari**


6.3. Struktura e studentëve në doktoraturë

